REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE

Data:	04.05.2018
Referencë:	
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Nga:	Ilir Tasholli - Drejtor i DSHP-së
Lënda:	**Raporti i muajit Prill 2018**

Në bazë të përgjegjësive dhe kompetencave gjatë muajit Prill 2018, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.
Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Prill				
Nr. i kërkesave të pranuara	**Të zgjidhura**	**Të refuzuara**	**Në kompetencë**	**Në procedurë**
49	**20**			**29**

- Janë dhënë Vendime, përgjigje, pëlqime, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Mbikëqyrja e kompanisë "Algemi" e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale, ku sipas kontratës është bërë mbushja e gropave me asfalt në rrugët e qyetit të Lipjanit si dhe në disa fshatra.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM "Pastrimi" NjO Lipjan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror.
- Mbikëqyrja e kompanisë "Eing Com" e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera në qytetin e Lipjanit, është bërë mbjellja e luleve dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara sipas kontratës për muajin Prill.
- Është intervenuar në mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Rr. Lidhja e Prizrenit ku është bërë rregullimi i shtyllës së ndriçimit publik e cila është dëmtuar si pasoj e aksidentit, si dhe është intervenuar në shtyllë afër Foto Vjosës, është rregulluar poçi i shkoqitur nga shtylla në Rr Hamdi Bislimi, është rregulluar rrjeti i ndriçimit publik në Rr Sadik Shala si dhe rregullimi i ndriçimit të fushës sportive "Xhavit Kozhani" në fsh Ribar i Madh.
- Është bërë barazimi i të hyrave me kompaninë Algemi, dhe barazimi i të hyrave nga hapësirat publike.
- Janë bërë kërkesa DBF për zotim të mjeteve për projektet kapitale si dhe kërkesa tjera nga mallra dhe shërbime.
- Mbikqyrja e kontratës për shenjëzim horizontal dhe vertikal të rrugëve në qytet dhe fshatra ku është bërë vendosja e e shenjave në afërsi të shkollave, hekurudhës etj.
- Është bërë kërkesa Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave: asfaltimi i rrugës në Grackë të Vjetër deri te rruga Kraishtë, asfaltimi i rrugëve në Brus dhe ndërtimi i kanalizimit në lagjen e Re Babush, asfaltimi i rrugës Dobrajë e Vogël-

Magurë, Ribar i Madh – Torinë, Torinë – Ribar i Vogël, ndërtimi i murit mbrojtës në Gadime, hapja dhe zgjerimi i lumenjëve në fshatrat e komunës.

- Janë bërë kërkesa Shërbimit Pronsoro Juridik dhe DGJK për definim të pronës dhe caktimin e pikave gjeodezike për: asfaltimi i rrugëve në fshatin Brus dhe kërkesë për inicimin e procedurës për shpronësim lidhur me rrugët "Bejtush Gërbeshi" dhe "Qamil Olluri" në Lipjan.

- Është përgaditur për Kuvend Propozim Vendimi për rregullimin e komunikacionit rrugor në disa rrugë të qytetit
- Kërkesë Drejtorisë së Inspektoriatit dhe Stacionit Policor për dalje në teren për inspektim gjatë ditëve të tregut dhe ndihmë në qarkullim të lirë të automjeteve në rrugën "Ismet Asllani"
- Është punuar dhe dorëzuar në MMPH projekti - Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Vrellë e Gadimes dhe ndërtimi i shtratit të lumit Sitnica.
- Pjesëmarrja në konferecën e donatorëve për financimin e projketeve për EE – sfidat e mileniumit 2018-2021.
- Pjesëmarrja e zyrtarëve në trajnim për EE organizuar nga GIZ dhe trajnim në e – prokurim: vlerësimi i ofertave
- Është plotësuar plani i integritetit nga fusha e shërbimeve publike.
- Pjesëmarja në vlerësime të ofertave tenderuese në Drejtoratin e Prokurimit
- Menaxherët e projekteve së bashku me kompaninë projektuese janë duke asistuar në përgatitjen e projekteve detale sipas prioriteteve.
- Janë përgatitë paramasa dhe parallogari.

- Mbikëqyrjet e punimeve të projekteve:
- Ndërtimi i stadionit në fshatin Dobrajë e Madhe punimet janë duke vazhduar
- Ndërtimi i shkollës fillore në fshtain Bregu u Zi punimet janë duke vazhduar
- Ndërtimi i zonës Industriale Qylagë, punimet janë duke vazhduar dhe janë në përfundim e sipër.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobrajë e Madhe punimet janë duke vazhduar dhe priten te asfaltohen rrugët e mbetura
- Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Janjevë punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ribar punimet janë ndërprer për shkak të paknaqësive që janë shprehur në mes banorëve të cilët kërkojnë që të asfaltohen të gjitha rrugët edhe pse me projekt nuk janë të përfshira të gjitha.
- Asfaltimi i rrugës Blinajë punimet janë duke vazhduar.
- Vazhdimi i punimeve të ndërtimit të 14 fushave të vogla sportive, punët janë duke vazhduar
- Asfaltimi i rrugës Babush i Muhaxherëve – Cërnillë, punimet kanë filluar.
- Kanalizimi në fshatin Leletiq, punimet kanë filluar.
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	**Lloji i aktivitetit**	**Nr.**
1	**Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera**	**34**
2	**Takime me përfaqësuesit e fshatrave**	**0**
3	**Përgatitja e paramasave dhe parallogarive**	**5**
4	**Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit**	**0**
5	**Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**	**0**
6	**Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal**	**0**
7	**Vizita në terren**	**35**
8	**Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme**	**4**
9	**Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve**	**4**